



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.113

15 gusht

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.520, datë 20.7.2011	Për ngritjen, përbërjen dhe detyrat e komisioneve të censusit të popullsisë dhe të banesave në qark 4463
Vendim i KM nr.533, datë 20.7.2011	Për ngritjen, përbërjen dhe detyrat e zyrave të censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki e komuna 4465
Udhëzim i MASH nr.22, datë 6.7.2011	Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, viti akademik 2011-2012..... 4468
Udhëzim i MASH nr.24, datë 15.7.2011	Për procedurat e botimit, shtypjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar nga Shtëpia Botuese e Librit Universitar..... 4472
Udhëzim i MASH nr.25, data 20.7.2011	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012..... 4473
Urdhër i MASH nr.194, datë 28.4.2011	Për hapjen e programeve të reja dhe fillimin e veprimtarisë akademike për këto programe, pranë shkollës së lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës”, Tiranë..... 4476
Urdhër i MASH nr.250, datë 2.6.2011	Për hapjen e programit të ri të studimit “Menaxhim-biznesi” dhe fillimin e veprimtarisë akademike për këtë program, pranë shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë..... 4477
Urdhër i MASH nr.310, datë 4.7.2011	Për hapjen e programeve të reja të studimit “Master profesional” në “Edukim” e “Financë-kontabilitet” dhe fillimin e veprimtarisë akademike për këto programe, pranë shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë..... 4477

Urdhër i MASH nr.336, datë 14.7.2011	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”...	4478
Urdhër i MASH nr.371, datë 28.7.2011	Për krijimin e Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.....	4478
Vendim i ERE nr.61, datë 13.7.2011	Për licencimin e shoqërisë “Bekim Energjetik” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	4480
Vendim i KKRT nr.182, datë 30.6.2011	Për dhënie licence për radion private vendore “Radio Dimension”.	4480
Vendim i KKRT nr.183, datë 30.6.2011	Për dhënie licence për radion private vendore “Radio Hit Fm”.....	4481
Vendim i KKRT nr.184, datë 30.6.2011	Për dhënie licence për radion private vendore “Radio Univers”.....	4481
Vendim i KKRT nr.185, datë 30.6.2011	Për dhënie licence për radion private vendore “Radio Number One”...	4482
Vendim i KKRT nr.186, datë 30.6.2011	Për dhënie licence për radion private vendore “Radio Sprint”.....	4482
Vendim i KKRT nr.202, datë 30.6.2011	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës “Radio Deutsche Welle”.....	4483
Vendim i KKRT nr.203, datë 30.6.2011	Për rinovimin e licencës dhe miratimin e ndryshimeve në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje licence të shoqërisë “Scorpion” sh.p.k., licencuar për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Maria”.....	4484
Vendim i KKRT nr.204, datë 30.6.2011	Për rinovimin e licencës dhe miratimin e ndryshimeve në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje licence të shoqërisë “Scorpion” sh.p.k., licencuar për subjektin radiofonik me përsëritës “World Family”.....	4485
Vendim i KKRT nr.206, datë 30.6.2011	Mbi miratimin e ndryshimeve në licencën e subjektit televiziv privat kabllor “Tv Pojan”.....	4486

VENDIM
Nr.520, datë 20.7.2011

**PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE DETYRAT E KOMISIONEVE TË CENSUSIT TË POPULLSISË
DHE TË BANESAVE NË QARK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr.8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Ngritja dhe përbërja e Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark

1. Ngritjen e komisioneve të censurit të popullsisë dhe të banesave në çdo qark, për organizimin dhe realizimin e censurit të popullsisë dhe të banesave brenda territorit të çdo qarku.

2. Komisioni i Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark kryesohet nga kryetari i këshillit të qarkut dhe ka në përbërje:

- | | |
|--|-------------|
| - Prefektin | nënkryetar; |
| - Përgjegjësin e zyrës së INSTAT-it në rrethin qendër qarku | nënkryetar; |
| - Drejtorin e drejtorisë rajonale të arsimit, në qark | anëtar; |
| - Drejtorin e drejtorisë rajonale të bujqësisë dhe ushqimit, në qark | anëtar; |
| - Drejtorin e drejtorisë së policisë së qarkut | anëtar. |

II. Detyrat e Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark

1. Në zbatim të udhëzimeve të INSTAT-it, Komisioni i Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark ushtron detyrat e mëposhtme:

a) Organizon punën e vet përgatitore dhe udhëzon veprimtaritë përgatitore e zbatuese të zyrave të censurit në bashki dhe komuna, të cilat janë pjesë e juridiksionit të qarkut të tyre;

b) Miraton programin e vet të punës për fazën përgatitore dhe fazën përfundimtare, dhe ndjek nëpërmjet inspektimit këtë proces në zyrat e censurit në bashkitë dhe komunat, të cilat janë pjesë e juridiksionit të qarkut të tyre;

c) Ndjek dhe monitoron procesin e përzgjedhjes e të rekrutimit, si dhe miraton listën e kontrollorëve, të paraqitur nga komisioni *ad-hoc* i vlerësimit, i ngritur nga INSTAT-i në qark, në përputhje me procedurat dhe standardet e përcaktuara nga ky institucion;

ç) Ndjek, nëpërmjet informacioneve, raporteve periodike dhe inspektimeve, procesin e trajnimit të kontrolleve të qarkut, që kryhet nga ekspertët dhe personeli tjetër, të angazhuar nga INSTAT-i;

d) Organizon dhënien e asistencës teknike nëpërmjet ekspertëve të INSTAT-it dhe profesionistëve të tjerë, për zyrat e censurit në bashki dhe komuna, që janë në juridiksionin e qarkut, në përputhje me vlerësimet në terren dhe nevojat e paraqitura prej tyre;

dh) Kryen inspektime periodike në zyrat e censurit në bashkitë dhe komunat, të cilat janë në juridiksionin e qarkut për ecurinë e punës së tyre dhe plotësimin e standardeve të përcaktuara nga legjislacioni dhe metodologjitë e udhëzimet e INSTAT-it, për censusin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave;

e) Raporton gjatë periudhës përgatitore, një herë në javë në INSTAT, për ecurinë e procesit të përgatitjes së censurit të përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave;

ë) Raporton çdo ditë në INSTAT, gjatë periudhës së censurit, për ecurinë e procesit të censurit të përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave;

f) Organizon dhe bashkërendon punën me zyrën rajonale të INSTAT-it, autoritetet e tjera pjesëmarrëse në këtë proces, në nivel qarku, si dhe me zyrat e censurit në bashkitë dhe komunat që janë në juridiksionin e qarkut për marrjen në dorëzim, magazinimin e pyetësorëve dhe materialeve të tjera shoqëruese, të nevojshme, në mënyrë të sigurt dhe për aq kohë sa është e nevojshme, si dhe transportimin e tyre në mënyrë të sigurt në zyrat e censurit në bashki dhe komuna, për realizimin e procesit të censurit në bashki dhe komuna;

g) Organizon, mbështet dhe bashkërendon punën për realizimin e procesit të grumbullimit dhe të dorëzimit, në afatin e përcaktuar nga INSTAT-i, të materialeve të censurit nga zyrat e censurit në bashkitë dhe komunat që janë në juridiksionin e qarkut;

gj) Vlerëson gjatë fazës përgatitore dhe gjatë periudhës së censurit nëse janë përmbushur detyrimet nga kryetari i bashkisë/komunës, njëkohësisht për realizimin e detyrave të përcaktuara në aktet nënligjore për zyrat e censurit të popullsisë dhe banesave në bashki e komuna.

2. Komisioni i Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark e ushtron veprimtarinë e tij nga data 15.8.2011 deri më 15.11.2011.

III. Detyrimet metodologjike

1. Komisioni i Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark është i detyruar të zbatojë udhëzimet që nxjerr INSTAT-i për:

- a) detyrat e personelit që angazhohet për kryerjen e censurit në terren;
- b) ndjekjen e zbatimit e veprimtarisë së censurit të popullsisë dhe të banesave nga komisionet e censurit, në nivel qarku;
- c) ngritjen e strukturave rajonale të censurit për mbështetjen e procesit të censurit në terren.

IV. Organizimi dhe funksionimi i mbledhjeve të Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark

1. Mbledhjet e Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark thirren nga kryetari dhe, në mungesë apo pamundësi të tij, nga nënkryetari i komisionit, prefekti i qarkut.

2. Në mbledhjen e Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark marrin pjesë vetëm anëtarët e tij. Kryetari i Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark, në varësi të çështjeve të parashikuara në rendin e ditës, mund të ftojë të marrin pjesë në mbledhjet e komisionit edhe:

a) specialistë të strukturave të autoriteteve shtetërore, në nivel qarku apo vendor, të cilat nuk përfaqësohen në Komisionin e Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark në njësinë ku funksionon Komisioni;

b) ekspertë apo personel tjetër, të angazhuar nga INSTAT-i në procesin e censurit të përgjithshëm të popullsisë dhe banesave.

3. Mbledhja e Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark drejtohet nga kryetari dhe, në mungesë apo pamundësi të tij, nga nënkryetari i komisionit, prefekti i qarkut, dhe, në mungesë të këtij të fundit, nga nënkryetari tjetër, si dhe është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit.

4. Mbledhjet si rregull organizohen çdo muaj, me përjashtim të rasteve kur problematika apo çështje të caktuara sjellin nevojën e organizimit të më shumë se një mbledhjeje në muaj.

5. Kryetari i Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark, bashkëlidhur njoftimit për mbledhje, u paraqet anëtarëve të komisionit:

- a) rendin e ditës së mbledhjes;
- b) dokumentacionin për çështjet, të cilat do të paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e komisionit.

6. Njoftimi për mbledhje dhe rendi i ditës nënshkruhen nga kryetari i Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark dhe, në mungesë të tij, nga nënkryetari i tij, prefekti.

7. Rendi i ditës, së bashku me dokumentacionin e çështjeve, të cilat do të paraqiten për shqyrtim, i propozohet kryetarit, në mungesë të tij nënkryetarit të Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark, prefektit, nga zyra e INSTAT-it në rrethin qendër të qarkut.

8. Kryetari dhe, në mungesë të tij, nënkryetari i Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark, prefekti, pasi shqyrton propozimin për rend dite dhe dokumentacionin e paraqitur, vendos datën e mbledhjes së komisionit, e cila, në asnjë rast, nuk mund të jetë më vonë se tre ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës nga zyra e INSTAT-it në rrethin qendër të qarkut.

9. Komisioni i Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark, për çështje të veçanta, mund të krijojë grupe pune, të cilat bëjnë vlerësime, vërejtje dhe rekomandime për çështje, të cilat janë në kompetencën e tyre, sipas detyrave të përcaktuara në pikën 1 të kreut II të këtij vendimi.

10. Vendimet në Komisionin e Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rast se votat janë të barabarta, vota e kryesuesit të mbledhjes vendos.

11. Vendimet, si dhe çështjet e tjera të shqyrtuara e të miratuara në mbledhjen e Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark, nënshkruhen nga kryesuesi i mbledhjes së komisionit.

12. Gjatë mbledhjes së Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark mbahet procesverbal, i cili miratohet në mbledhjen e ardhshme të komisionit.

13. Sekretariati i Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark përbëhet nga punonjës të Këshillit të Qarkut dhe të zyrës së INSTAT-it në rrethin qendër të qarkut, të cilët miratohen nga komisioni, dhe ka për detyrë:

- a) të verifikojë ekzistencën e numrit të mjaftueshëm të anëtarëve për zhvillimin e mbledhjes;
- b) të organizojë punën sipas orientimeve të kryetarit të Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe për shqyrtimin e çështjeve të përcaktuara në rendin e ditës së mbledhjes së komisionit;
- c) të bashkëpunojë me autoritetet shtetërore, në nivel qarku dhe vendor, për përgatitjen e materialeve të rendit të ditës që Komisioni i Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark do të marrë në shqyrtim;

ç) të dërgojë materialet e përgatitura për mbledhjen e radhës të secili anëtar i Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara mbledhjes;

d) të mbajë dhe të zbardhë procesverbalet e mbledhjeve;

dh) të ndjekë procesin e nënshkrimit të vendimeve të marra në mbledhjen paraardhëse të Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark.

V. Dispozita të përgjithshme

1. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark, për periudhën e funksionimit të tij, është 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj. Mënyra e pagesës përcaktohet me udhëzim të veçantë të INSTAT-it.

2. Vendimi nr.728, datë 28.12.2000 i Këshillit të Ministrave “Për ngritjen, përbërjen dhe detyrat e komisioneve të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në qarqe (prefektura)”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Komisioni Qendror i Censurit dhe komisionet e censurit të popullsisë dhe të banesave në çdo qark, zyrat e censurit në bashki dhe komuna, si dhe INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.533, datë 20.7.2011

PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE DETYRAT E ZYRAVE TË CENSUSIT TË POPULLSISË DHE TË BANESAVE NË BASHKI E KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8669, datë 26.10.2000 “Për censusin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit”, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Ngritja dhe përbërja e zyrave të censurit të popullsisë dhe të banesave në bashki dhe komuna

1. Ngritjen e zyrave të censurit të popullsisë dhe të banesave në çdo bashki e komunë, për organizimin dhe realizimin e censurit të popullsisë dhe të banesave brenda territorit përkatës së bashkisë dhe komunës.

2. Zyra e censurit të popullsisë dhe të banesave në bashki përbëhet nga:

- | | |
|--|-------------|
| - Kryetari i bashkisë | kryetar; |
| - Mbikëqyrësi | nënkryetar; |
| - Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile | anëtar; |
| - Drejtuesi i strukturës së shërbimeve sociale në bashki | anëtar; |
| - Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit | anëtar. |

2.1 Në bashkinë e Tiranës ngrihen zyrat e censurit të popullsisë dhe të banesave edhe në 11 njësitë bashkiake me përbërjen e mëposhtme:

- | | |
|--|-------------|
| - Kryetari i njësisë bashkiake | kryetar; |
| - Përfaqësuesi i INSTAT-it (mbikëqyrësi) | nënkryetar; |
| - Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile | anëtar; |
| - Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit | anëtar. |

3. Zyra e censurit të popullsisë dhe të banesave në komunë përbëhet nga:

- | | |
|---|-------------|
| - Kryetari i komunës | kryetar; |
| - Përfaqësuesi i INSTAT-it (kontrollor) | nënkryetar; |
| - Përgjegjës i gjendjes civile | anëtar; |
| - Punonjësi i zyrës së urbanistikës | anëtar; |
| - Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit | anëtar. |

4. Zyrat e censurit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komuna do të drejtohen nga personi i ngarkuar nga prefekti në rastet kur:

a) bazuar në raportet periodike, sipas shkronjës “e” të pikës 1 të kreut II të këtij vendimi, të paraqitura pranë Komisionit të Censurit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark dhe në INSTAT, vlerësohet nga Komisioni i Censurit në Qark se nuk janë përmbushur detyrimet nga kryetari i bashkisë/komunës për të realizuar detyrat e përcaktuara për këtë zyrë në kërret II, III dhe IV të këtij vendimi;

b) kryetari i ri i zgjedhur i bashkisë/komunës nuk ka marrë ende mandatin sipas procedurës së përcaktuar në nenin 40 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

II. Detyrat e zyrove të censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komuna

1. Në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Statistikave (INSTAT), zyrat e censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komuna ushtrojnë detyrat e mëposhtme:

a) Organizojnë punën për censusin e popullsisë dhe të banesave dhe ndjekin, udhëzojnë dhe inspektojnë veprimtaritë përgatitore të personelit të censusit në zonat e censusit që bëjnë pjesë në juridiksionin e territorit të bashkisë apo komunës së tyre;

b) Miratojnë programin e punës së zyrës së censusit të popullsisë dhe të banesave të bashkisë apo komunës, si për fazën përgatitore dhe atë përfundimtare, dhe ndjekin këtë proces nëpërmjet inspektimit në të gjitha zonat e censusit që bëjnë pjesë në juridiksionin e tyre;

c) Ndjekin dhe monitorojnë procesin e përzgjedhjes e të rekrutimit, si dhe miratojnë listën e anketuesve, të paraqitur nga komisioni *ad-hoc* i vlerësimit, i ngritur nga INSTAT-i në çdo bashki dhe komunë, në përputhje me procedurat dhe standardet e përcaktuara nga ky institucion;

ç) Ndjekin dhe sigurojnë pjesëmarrjen e anketuesve në procesin e trajnimit që organizohet nga ekspertët dhe personeli tjetër, të angazhuar nga INSTAT-i;

d) Organizojnë punën për ofrimin e asistencës teknike për anketuesit, nëpërmjet ekspertëve dhe profesionistëve të tjerë të INSTA-it, në përputhje me vlerësimet në terren dhe nevojat e paraqitura prej tyre;

dh) Organizojnë inspektime periodike në bashkëpunim me kontrollorët në procesin e anketimit dhe ndjekin në vazhdimësi, nëpërmjet mbikëqyrësve, mbarëvajtjen dhe cilësinë e censusit, me qëllim plotësimin e standardeve të përcaktuara nga legjislacioni, si dhe metodologjinë e udhëzimet e INSTAT-it për censusin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave;

e) Raportojnë pranë Komisionit të Censusit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark dhe në INSTAT lidhur me ecurinë e procesit të censusit të përgjithshëm të popullsisë dhe banesave:

i) një herë në javë gjatë periudhës përgatitore;

ii) çdo ditë në periudhën e numërimit.

ë) Organizojnë punën në bashkëpunim me punonjësin e INSTAT-it, në nivel bashkie/komune, dhe me Komisionin e Censusit të Popullsisë dhe Banesave në Qark, për sigurimin e mjediseve të nevojshme, marrjen në dorëzim dhe magazinimin e pyetësorëve dhe të materialeve të tjera shoqëruese në mënyrë të sigurt dhe për aq kohë sa është e nevojshme, për procesin e censusit të popullsisë në të gjithë territorin e njësisë vendore;

f) Sigurojnë mjediset e nevojshme për bashkërendimin e punës ndërmjet anketuesve, kontrollorëve e mbikëqyrësve, për të arritur plotësimin me cilësi të anketave dhe zgjidhjen e problemeve të tjera që lindin në procesin e censusit në terren;

g) Organizojnë procesin e ruajtjes dhe të dorëzimit të materialeve të censusit në afatin e përcaktuar në Komisionin e Censusit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark dhe në INSTAT.

2. Zyrat e censusit të popullsisë dhe të banesave në njësitë bashkiake në Bashkinë e Tiranës kanë detyrat e mëposhtme:

a) Raportojnë pranë Komisionit të Censusit të Popullsisë dhe të Banesave në Bashkinë e Tiranës lidhur me ecurinë e procesit të censusit të përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave:

i) një herë në javë gjatë periudhës përgatitore;

ii) çdo ditë në periudhën e censusit;

b) Organizojnë punën në bashkëpunim me punonjësit e INSTAT-it në njësinë bashkiake dhe me Komisionin e Censusit të Popullsisë e të Banesave në Bashkinë e Tiranës, për sigurimin e mjediseve të nevojshme, marrjen në dorëzim dhe magazinimin e pyetësorëve dhe të materialeve të tjera shoqëruese në mënyrë të sigurt dhe për aq kohë sa është e nevojshme, për procesin e censusit të popullsisë në të gjithë territorin e njësisë vendore;

c) Sigurojnë mjediset e nevojshme për bashkërendimin e punës ndërmjet anketuesve, kontrollorëve e mbikëqyrësve, për të arritur plotësimin me cilësi të anketave dhe zgjidhjen e problemeve të tjera që lindin në procesin e censusit në terren, me mbështetjen e Bashkisë së Tiranës;

ç) Organizojnë procesin e ruajtjes dhe të dorëzimit të materialeve të censusit në afatin e përcaktuar në Komisionin e Censusit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark dhe në INSTAT, me mbështetjen e Bashkisë së Tiranës.

3. Zyrat e censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komuna dhe njësitë bashkiake Tiranë, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nga data 15.8.2011 deri më datën 15.11.2011.

III. Detyrimet metodologjike

Zyrat e censusist të popullsisë dhe të banesave në bashki/komuna janë të detyruara të zbatojnë udhëzimet që nxjerr INSTAT-i për:

- a) detyrat e pesonelit që angazhohet për kryerjen e censusit në terren;
- b) ndjekjen dhe zbatimin e veprimtarisë së censusit të popullsisë dhe të banesave nga vetë këto zyra.

IV. Organizimi dhe funksionimi i mbledhjeve të zyrave të censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komuna dhe njësitë bashkiake, Tiranë

1. Mbledhjet e zyrave të censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë thirren nga kryetari dhe, në mungesë të tij, nga nënkryetari.

2. Në mbledhjen e zyrës së censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komuna marrin pjesë vetëm anëtarët e tij. Kryetari i kësaj zyre, në varësi të çështjeve të parashikuara në rendin e ditës, mund të ftojë të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit edhe:

a) specialistë të strukturave të autoriteteve shtetërore në nivel qarku apo vendor, të cilat nuk përfaqësohen në zyrën e censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë në njësinë ku funksionon Komisioni;

b) ekspertë apo personel tjetër, të angazhuar nga INSTAT-i në procesin e censusit të përgjithshëm të popullsisë dhe banesave.

3. Mbledhja e zyrës së censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë drejtohet nga kryetari dhe, në mungesë të tij, nga nënkryetari, si dhe është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të zyrës.

4. Mbledhjet, si rregull, organizohen një herë në muaj, me përjashtim të rasteve kur problematika apo çështje të caktuara sjellin nevojën e organizimit të më shumë se një mbledhjeje në muaj.

5. Kryetari i zyrës së censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë, bashkëlidhur njoftimit për mbledhje, u paraqet anëtarëve të zyrës:

- a) rendin e ditës së mbledhjes;
- b) dokumentacionin për çështjet, të cilat do të paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e zyrës.

6. Njoftimi për mbledhje dhe rendi i ditës nënshkruhen nga kryetari i zyrës së censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë dhe, në mungesë të tij, nga nënkryetari i tij.

7. Rendi i ditës së bashku me dokumentacionin e çështjeve, të cilat do të paraqiten për shqyrtim, i propozohet nga punonjësi i INSTAT-it në rreth kryetarit dhe, në mungesë të tij, nënkryetarit. Për komunat, propozimi i rendit të ditës bëhet nga punonjësi i INSTAT-it në rrethin, në juridiksionin e të cilit është komuna.

8. Kryetari dhe, në mungesë të tij, nënkryetari, pasi shqyrton propozimin për rend dite dhe dokumentacionin e paraqitur, vendos datën e mbledhjes së Komisionit, e cila në asnjë rast nuk mund të jetë më vonë se tri ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës nga punonjësi i INSTAT-it, sipas përcaktimit në pikën 7 të këtij kreu.

9. Zyra e censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë, për çështje të veçanta, mund të krijojë grupe pune, të cilat bëjnë vlerësime, vërejtje dhe rekomandime për çështje të cilat janë në kompetencën e tyre, sipas detyrave të përcaktuara në pikën 1 të kreut II të këtij vendimi.

10. Vendimet në zyrën e censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë merren e shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rast se votat janë të barabarta, vota e kryesuesit të mbledhjes vendos.

11. Vendimet, si dhe çështjet e tjera të shqyrtuara dhe të miratuara në mbledhjen e zyrës së censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë nënshkruhen nga kryesuesi i mbledhjes së zyrës.

12. Gjatë mbledhjes së zyrës së censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë mbahet procesverbal, i cili miratohet në mbledhjen e ardhshme të zyrës.

13. Sekretariati i zyrës së censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë përbëhet nga punonjës të bashkisë/komunës dhe punonjës të INSTAT-it, atje ku ka të tillë, miratohet nga zyra dhe ka për detyrë:

- a) të verifikojë ekzistencën e numrit të mjaftueshëm të anëtarëve për zhvillimin e mbledhjes;
- b) të organizojë punën sipas orientimeve të kryetarit të zyrës së censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe për shqyrtimin e çështjeve të përcaktuara në rendin e ditës së mbledhjes së zyrës;
- c) të bashkëpunojë me autoritete shtetërore, në nivel qarku dhe vendor, për përgatitjen e materialeve të rendit të ditës që zyra e censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë do të marrë në shqyrtim;
- ç) të dërgojë materialet e përgatitura për mbledhjen e radhës të secili anëtar i zyrës së censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë jo më vonë se 3 (tri) ditë përpara mbledhjes;
- d) të mbajë dhe të zbardhë procesverbalet e mbledhjeve;

dh) të ndjekë procesin e nënshkrimit të vendimeve të marra në mbledhjen paraardhëse të zyrës së censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë.

V. Dispozita të përgjithshme

1. Masa e shpërblimit të anëtarëve të zyrës së censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë, për të gjithë periudhën e funksionimit të komisionit, është 3000 (tre) mijë lekë në muaj. Mënyra e pagesës të përcaktohet me udhëzim të veçantë të INSTAT-it.

2. Vendimi nr.734, datë 28.12.2000 i Këshillit të Ministrave “Për ngritjen, përbërjen dhe detyrat e zyrtarëve të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në bashki dhe komuna”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Komisioni Qendror i Censusit, Komisioni i Censusit të Popullsisë dhe të Banesave në Qark, zyra e censusit të popullsisë dhe të banesave në bashki/komunë dhe INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.22, datë 6.7.2011

PËR ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË PRANIMIT, TARIFËN E REGJISTRIMIT PËR KONKURRIM NË DISA PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, VITI AKADEMIK 2011-2012

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe në nenin 33 dhe 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pranimet në vitin akademik 2011-2012, në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë në Universitetin e Arteve, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë “Arkitekturë” dhe “Arkitekturë-urbanist” të Universitetit Politeknik të Tiranës, “Edukim fizik dhe sporte” dhe “Pikturë-grafikë” në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, si dhe programin e studimit “Edukim fizik dhe sporte” në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, programet e studimit të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të bëhen mbi bazën e rezultateve të Maturës Shtetërore dhe të rezultateve të fituara nga konkursi i pranimit, i organizuar nga këto institucione publike të arsimit të lartë.

2. Në Universitetin e Arteve rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e të katër ose pesë viteve të shkollimit dhe katër provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 30% dhe rezultatet e konkursit të pranimit në masën 70%, sipas tabelës nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi. Kandidati që nuk kalon pragun e pikëve minimale të konkursit të pranimit, sipas tabelës nr.2, bashkëngjitur këtij udhëzimi, në të gjitha programet e studimit të Universitetit të Arteve, nuk fiton të drejtën e studimit.

3. Në Universitetin e Sporteve të Tiranës

3.1 Në programin e studimit “Shkencat e lëvizjes”, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e të katër ose pesë viteve të shkollimit dhe katër provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 50%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 50%, sipas tabelës nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

3.2 Në programin e studimit “Fushat e veprimtarisë fizike, të shëndetit dhe të rekreacionit”, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e të katër ose pesë viteve të shkollimit dhe katër provimet e Maturës Shtetërore) të llogariten në masën 50%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 50%, sipas tabelës nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4. Në programet e studimit “Arkitekturë” dhe “Arkitekturë-urbanist” në Universitetin Politeknik të Tiranës, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e të katër ose pesë viteve të shkollimit dhe katër provimet e Maturës Shtetërore) të llogariten në masën 40%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 60%, sipas tabelës nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

5. Në programin e studimit “Edukim fizik dhe sporte” dhe “Pikturë-grafikë” të universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e të katër ose pesë viteve të shkollimit dhe

katër provimet e Maturës Shtetërore) të llogariten në masën 50%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 50%, sipas tabelës nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

6. Në programin e studimit “Pikturë-grafikë” të universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e të katër ose pesë viteve të shkollimit dhe katër provimet e Maturës Shtetërore) të llogariten në masën 40%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 60%, sipas tabelës nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

7. Në programet e studimit të “Edukim fizik dhe sporte” të universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e të katër ose pesë viteve të shkollimit dhe katër provimet e Maturës Shtetërore) të llogariten në masën 50%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 50%, sipas tabelës nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

8. Në programin e studimit FASTIP të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e të katër ose pesë viteve të shkollimit dhe katër provimet e Maturës Shtetërore) të llogariten në masën 80%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit (gjuha angleze) në masën 20%, sipas tabelës nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

9. Për të gjitha programet e studimit, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, pikët minimale dhe maksimale të konkurseve përcaktohen në tabelën nr.2, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

10. Rregulloret dhe programet e konkurseve, të miratuara nga IAL-të publike përkatëse, të bëhen publike duke filluar nga data 1 gusht 2011.

11. Kandidatët që kanë kërkuar në formularin A2, programet e studimit në Universitetin e Arteve, programet e studimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, programet e studimit “Arkitekturë” dhe “Arkitekturë-urbanist” të Universitetit Politeknik të Tiranës, programet e studimit “Edukim fizik dhe sporte” dhe “Pikturë-grafikë” në universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, programin e studimit “Edukim fizik dhe sporte” në universitetin “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit, programet e studimit të FASTIP të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, si dhe kandidatët shqiptarë që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit për këto programe studimi nga Republika e Kosovës, nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga lugina e Preshevës, të regjistrohen për zhvillimin e konkursit pranë sekretarive mësimore të fakultetit përkatës. Periudha e regjistrimit të jetë data 16 gusht 2011 deri në orën 12:00 të datës 27 gusht 2011.

12. Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), deri në datën 14 gusht 2011, të përgatitë listën e konkurrentëve për konkurset e pranimit në programet e studimit në Universitetin e Arteve, në programet e studimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, programet e studimit “Arkitekturë” dhe “Arkitekturë-urbanist” të Universitetit Politeknik të Tiranës, programet e studimit “Edukim fizik dhe sporte” dhe “Pikturë-grafikë” në universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, programin e studimit “Edukim fizik dhe sporte” në universitetin “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit, programet e studimit të FASTIP të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, sipas preferencës së kërkuar prej tyre në formularin A2.

13. Listat e konkurrentëve për secilin konkurs pranimi, të pikës 1, në formë të shkruar dhe elektronike, t’u dorëzohen institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas programit të studimit, në datën 15 gusht 2011, nga AKP-ja për të gjithë kandidatët që kanë plotësuar formularin A2 dhe nga MASH-i për kandidatët shqiptarë që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit për këto programe studimi nga Republika e Kosovës, nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga lugina e Preshevës.

14. Rektoratet dhe dekanatet e IAL publike të shpallin në mjedise të dukshme të institucioneve të tyre deri në datën 10 gusht 2011: datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për të siguruar një ecuri normale të procesit të regjistrimeve në konkursin e pranimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë.

15. Sekretaritë mësimore të fakulteteve përkatëse, të programeve të studimit të pikës 1 dhe 2, pas verifikimit të listave të të regjistruarve me listën e dorëzuar nga AKP-ja dhe nga MASH-i, në datën 27 gusht 2011, ora 12:00, të shpallin listat e konkurrentëve të regjistruar dhe t’i afishojnë ato në vende të dukshme në mjediset e fakulteteve të tyre.

16. Datat e konkursit të pranimit në këto institucione publike të arsimit të lartë, të jenë sipas këtij kalendari:

16.1 Universiteti i Arteve, Tiranë, për të gjitha programet e studimit në:

- | | |
|-----------------------------------|----------------------------|
| a) Fakultetin e Muzikës | 29 gusht - 2 shtator 2011; |
| b) Fakultetin e Artit Skenik | 29 gusht - 2 shtator 2011; |
| c) Fakultetin e Arteve Figurative | 29 gusht - 2 shtator 2011. |

16.2 Universiteti i Sporteve të Tiranës, për programet e studimit:

- | | |
|---|-------------------|
| a) Shkenca të lëvizjes | 29-31 gusht 2011; |
| b) Fushat e veprimtarisë fizike, të shëndetit dhe të rekreacionit | 29-31 gusht 2011. |

16.3 Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për programin e studimit:

- a) Edukim fizik dhe sporte 29-31 gusht 2011;
b) Pikturë-grafikë 29-31 gusht 2011.

16.4 Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për programin e studimit:

- a) Edukim fizik dhe sporte 29-31 gusht 2011.

16.5 Universiteti Politeknik i Tiranës, për programet e studimit:

- a) Arkitekturë 29-31 gusht 2011;
b) Arkitekturë (urbanist) 29-31 gusht 2011.

16.6 Universiteti “Aleksandër Moisiu” i Durrësit (FASTIP), për programet e studimit:

- a) Menaxhim i bankave 29-31 gusht 2011;
b) Menaxhim hoteleri-turizëm 29-31 gusht 2011;
c) Menaxhim i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme 29-31 gusht 2011.

17. Tarifat e regjistrimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkurset e pranimit në këto institucione publike të arsimit të lartë, të jenë si më poshtë:

- a) Në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës: 5 000 (pesë mijë) lekë;
b) Në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Arteve: 5 000 (pesë mijë) lekë;
c) Në programet e studimit në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër:

“Edukim fizik dhe sporte”: 5 000 (pesë mijë) lekë dhe “Pikturë-grafikë”: 7 000 (shtatë mijë) lekë;

d) Në programin e studimit “Edukim fizik dhe sporte” në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan: 4 000 (katër mijë) lekë;

e) Në programin e studimit “Arkitekturë” dhe “Arkitekturë-urbanist” në Universitetin Politeknik të Tiranës: 8 000 (tetë mijë) lekë.

18. Të gjitha tarifat e regjistrimit për konkurrim në programet e ndryshme të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë të arkëtohen nëpërmjet sistemit bankar ose zyrave të Postës Shqiptare, për llogari të IAL-së publike përkatëse.

19. Konkursat e pranimit në këto institucione publike të arsimit të lartë të monitorohen nga përfaqësues të MASH-it.

20. Rezultatet e konkurseve të pranimit të dërgohen në MASH e në AKP në letër dhe CD, brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre. Për konkurrentët nga Republika e Kosovës, vetë IAL-të publike përkatëse të shpallin kandidatët fitues, sipas kuotave të miratuara për çdo program studimi.

21. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe e Kërkimit Shkencor, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe institucionet publike përkatëse të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

TABELA NR.1

PËRQINDJET E MATURËS SHTETËRORE DHE KONKURSEVE

Nr.	Programi i studimit	Universiteti	% Matura	% Konkurs
1	Arkitekturë (arkitekt)	Universiteti Politeknik i Tiranës	40	60
2	Arkitekturë (urbanist)	Universiteti Politeknik i Tiranës	40	60
3	Edukim fizik e sporte	Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan	50	50
4	Pikturë-grafikë	Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	40	60
5	Edukim fizik e sporte	Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	50	50
6	Regji filmi dhe TV	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
7	Aktrim	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
8	Regji	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
9	Skenografi-kostumografi	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
10	Koreografi	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
11	Pikturë	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
12	Skulpturë	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70

13	Muzikologji	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
14	Kompozim	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
15	Dirigjim	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
16	Piano	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
17	Violinë	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
18	Violonçel	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
19	Violë	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
20	Kitarë	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
21	Kontrabas	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
22	Flaut	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
23	Oboe	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
24	Klarinetë	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
25	Fagot	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
26	Korno	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
27	Trombë	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
28	Trombonë	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
29	Bastub	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
30	Këngëtare	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
31	Pedagogji muzikore	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
32	Fizarmonikë klasike	Universiteti i Arteve të Tiranës	30	70
33	Shkenca të lëvizjes	Universiteti i Sporteve të Tiranës	50	50
34	Fushat e veprimtarisë fizike të shëndetit dhe rekreacionit	Universiteti i Sporteve të Tiranës	50	50
35	Menaxhim i bankave	FASTIP - Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	80	20
36	Menaxhim hotelieri-turizëm	FASTIP - Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	80	20
37	Menaxhim i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	FASTIP - Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	80	20

TABELA NR.2

TABELA E PIKËVE MAKSIMALE DHE MINIMALE NË KONKURSE

Nr.	Programi i studimit	Universiteti	P. Maks.	P. Min.
1	Arkitekturë (arkitekt)	Universiteti Politeknik i Tiranës	65	0
2	Arkitekturë (urbanist)	Universiteti Politeknik i Tiranës	65	0
3	Edukim fizik e sporte	Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan	70	0
4	Pikturë-grafikë	Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	70	0
5	Edukim fizik e sporte	Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	70	0
6	Regji filmi dhe TV	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
7	Aktrim	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
8	Regji	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
9	Skenografi-kostumografi	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
10	Koreografi	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
11	Pikturë	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	90
12	Skulpturë	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	90
13	Muzikologji	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
14	Kompozim	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
15	Dirigjim	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
16	Piano	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
17	Violinë	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
18	Violonçel	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60

19	Violë	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
20	Kitarë	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
21	Kontrabas	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
22	Flaut	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
23	Oboe	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
24	Klarinetë	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
25	Fagot	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
26	Korno	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
27	Trombë	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
28	Trombonë	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
29	Bastub	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
30	Këngëtare	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
31	Pedagogji muzikore	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
32	Fizarmonikë klasike	Universiteti i Arteve të Tiranës	240	60
33	Shkenca të lëvizjes	Universiteti i Sporteve të Tiranës	70	0
34	Fushat e veprimtarisë fizike të shëndetit dhe rekreacionit	Universiteti i Sporteve të Tiranës	70	0
35	Menaxhim i bankave	FASTIP - Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	100	40
36	Menaxhim hotelieri-turizëm	FASTIP - Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	100	40
37	Menaxhim i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	FASTIP - Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	100	40

UDHËZIM
Nr.24, datë 15.7.2011

**PËR PROCEDURAT E BOTIMIT, SHTYPJES, SHPËRNDARJES DHE SHITJES
SË TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NGA SHTËPIA
BOTUESE E LIBRIT UNIVERSITAR**

Në zbatim të vendimit nr.107, datë 10.2.2010 të Këshillit të Ministrave "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar", të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.120, datë 27.1.1997 "Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor",

UDHËZOJ:

1. Shtëpia Botuese e Librit Universitar (SHBLU) do të realizojë botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të sistemit parauniversitar, ku përfshihen tekstet për shkollat profesionale (teknike, social-kulturore e të gjuhëve të huaja), si dhe tekstet e pakicave kombëtare greke dhe maqedonase.

2. Në çdo vit, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (MASH) dërgon në SHBLU listën e teksteve të kërkuara për botim. Për secilin tekst dërgohen planet mësimore, tirazhet respektive dhe specifikime të tjera.

3. SHBLU-ja përllogarit koston paraprake, të cilën e dërgon në MASH, për të kërkuar miratimin e fondeve buxhetore të nevojshme.

4. Për secilin tekst të miratuar për botim, SHBLU-ja formon grupet e autorëve, komisionet e posaçme për diskutimin dhe miratimin e teksteve dhe organizon fillimin e procedurës së botimit.

5. SHBLU-ja lidh kontrata paraprake bashkëpunimi me autorët e teksteve.

6. Për të garantuar cilësi të plotë të botimit, ajo zbaton me korrektësi të gjithë skemën teknologjike të përgatitjes së teksteve.

7. Vetëm pas miratimit të tekstit nga këshilli botues i SHBLU-së, nënshkruhet kontrata me autorët dhe bëhet shpërblimi i autorësisë, sipas tarifave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.120, datë 27.1.1997 "Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor".

8. Në rastet e përshtatjes së teksteve të minoritetit grek dhe maqedonas nga versioni shqip, MASH-i siguron edhe lejen e botimit nga botuesi përkatës.

9. Kur tirazhi i teksteve të kërkuara për botim (ose procese të veçanta të tij) nuk realizohet me mundësitë dhe pajisjet teknologjike të SHBLU-së, ajo kooperon me shtëpi botuese apo shtypshkronja të tjera, duke zbatuar procedurat ligjore në fuqi.

10. SHBLU-ja bën kolaudimin e produktit, nënshkruan lejen e qarkullimit, bën publicitetin e tekstit dhe dorëzon 5 kopje të tij në Bibliotekën Kombëtare.

11. Çdo tekst pajiset me ISBN, dhe në kopertinën e tij vendoset çmimi i miratuar nga MASH-i, si dhe pulla me hologramën, e cila sigurohet falas nga MASH-i.

12. SHBLU-ja për të gjitha proceset që lidhen me autorësinë (përfshirë edhe ribotimin e ripunimin), parapërgatitjen, pjesëmarrjen në komisionet e posaçme për diskutimin dhe miratimin e teksteve, zbaton tarifat e shpërblimeve sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.120, datë 27.1.1997 “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera në dokumentacionin shkollor”.

13. Shpërndarja dhe shitja e teksteve do të bëhet nga SHBLU-ja. Drejtoritë e shkollave do të lejojnë shitjen e teksteve në mjediset e tyre dhe sipas kushteve do të vënë në dispozicion të SHBLU-së mjedise magazinuese për tekstet.

14. Të ardhurat nga shitja e teksteve do të derdhen në numrin e llogarisë së të ardhurave të SHBLU-së, dhe do të përdoren sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.7.1998 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, pika 1/b, dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nr.33, datë 10.10.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore”.

Të ardhurat nga shitja e teksteve do të derdhen në numrin e llogarisë së të ardhurave në thesar të SHBLU-së, me adresë:

SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT UNIVERSITAR, TIRANË

Nr.llogarisë: 0104030780

IBAN Code: AL22202110130000000104030780

15. Në fund të çdo viti, SHBLU-ja dërgon në MASH raportin dhe analizën financiare për realizimin e botimeve.

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi do të përballohen nga buxheti i planifikuar i MASH-it.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.25, data 20.7.2011

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE
ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN
AKADEMIK 2011-2012**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës pika 5, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.423, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2011-2012”, të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar, të vendimit nr.1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP),

UDHËZOHJ:

1. Pranimi i kandidatëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë (IAL), në vitin akademik 2011-2012, të bëhet sipas listave emërore të renditura nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH).

2. Kandidatët fitues të përcaktohen nga AKP-ja në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës përcaktohet sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore (nota mesatare e të katër ose pesë viteve të shkollimit dhe katër

provimet e Maturës Shtetërore), dhe për disa programe studimi, edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr.22, datë 6.7.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe studimi në ciklin e parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2011-2012”;

b) Parimi i preferencës përcaktohet nga vullneti i kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të grupit të preferencave fituese, ndër jo më shumë se 10 preferenca të përzgjedhura nga ata vetë në formularin A2.

3. Pas përfundimit të konkurseve në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, rezultatet e tyre në format elektronik dhe *hard copy* të dorëzohen nga këto të fundit në AKP brenda orës 14:00 të datës 5 shtator 2011. AKP-ja brenda datës 11 shtator 2011 të dërgojë në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës listat paraprake të kandidatëve fitues, të ndara sipas programeve të studimit përkatës, të renditura sipas rendit zbritës të pikëve dhe të preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre në formularin A2, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara me vendimin nr.423, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe tarifën e shkollimit për vitin akademik 2011-2012”.

4. Listat paraprake të kandidatëve fitues shpallen në faqen zyrtare të MASH-it dhe u dërgohen, në formë të shkruar dhe elektronike, institucioneve publike të arsimit të lartë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Provimeve në datën 11 shtator 2011. Këto institucione, duke filluar nga kjo datë, t’i afishojnë listat në vende të dukshme në mjediset e fakulteteve përkatëse.

5. Për organizimin dhe realizimin e procesit të pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë të ngarkohen fakultetet e institucioneve publike të arsimit të lartë. Ky proces do të jetë nën monitorimin e rektorateve dhe të Ministrisë së Arsimit e të Shkencës.

6. Regjistrimi i kandidatëve për të fituar statusin e studentit të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë të zhvillohet në dy faza:

6.1 Regjistrimi paraprak;

6.2 Regjistrimi përfundimtar.

7. Regjistrimi paraprak

7.1 Kandidatët fitues bëjnë regjistrimin paraprak të tyre në programin e studimit ku janë shpallur paraprakisht fitues pranë sekretarive mësimore të fakulteteve nga data 12 shtator 2011 deri në datën 18 shtator 2011, nga ora 08:00 deri në orën 18:00.

7.2 Për regjistrimin paraprak, kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të dorëzojë dosjen individuale me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) diplomë e Maturës Shtetërore, së bashku me listën e notave. Për maturantët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011, dëftesë pjekurie (në mungesë të origjinalit, vërtetim me listë notash me fotografi ose dokument me fotografi i lëshuar nga Arkivi i Shtetit me notat përkatëse të nënshkruara nga drejtori i shkollës dhe nga drejtori i drejtorisë arsimore rajonale/zyrës arsimore);

b) dokument identifikimi (letërnjoftim ID, pasaportë) dhe fotokopje të tij. Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

c) 2 fotografi;

d) mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1.550 lekësh, paguar për llogari të universitetit në një nga bankat e nivelit të dytë.

7.3 Në kryerjen e procedurës së regjistrimit paraprak, sekretaritë mësimore të fakulteteve mbajnë regjistër të veçantë në të cilin kandidatët fitues nënshkruajnë në momentin e regjistrimit për dorëzimin e dokumenteve, duke shënuar datën dhe orën e regjistrimit.

7.4 Sekretaria mësimore pajis kandidatin që bën regjistrimin paraprak me një fletëregjistrimi paraprake, ku shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si edhe data dhe ora e regjistrimit. Fletëregjistrimi paraprak duhet të jetë e nënshkruar nga dekan i fakultetit dhe e vulosur.

8. Institucionet publike të arsimit të lartë deri në orën 14:00 të datës 20 shtator 2011, të dorëzojnë në MASH dhe në AKP listën origjinale të përgatitur nga AKP-ja me regjistrimet paraprake të kryera në formë të shkruar dhe elektronike, në dy kopje, sipas udhëzimit të përgatitur nga AKP-ja.

9. Kandidatët të cilët nuk kryejnë regjistrimin paraprak brenda datave të përcaktuara në këtë udhëzim, për çfarëdolloj arsye, humbasin të drejtën e regjistrimit dhe të vazhimit të procesit. Këta kandidatë nuk do të përfshihen në listën përfundimtare të fituesve.

10. Në bazë të regjistrimeve paraprake të kryera dhe të vendeve të paplotësuara, AKP-ja në datën 23 shtator 2011, të shpallë listën përfundimtare të kandidatëve fitues, duke ruajtur parimet e shprehura në pikën 2 të këtij udhëzimi. Lista shpallet edhe në faqen *web* të MASH-it.

11. Listat përfundimtare e kandidatëve fitues në formë të shkruar dhe elektronike, t'u dorëzohen institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas programeve përkatëse të studimit në datën 24 shtator 2011 nga Agjencia Kombëtare e Provimeve. Institucionet publike të arsimit të lartë t'i afishojnë listat brenda datës 25 shtator 2011.

12. Regjistrimi përfundimtar

12.1 Kandidatët të cilët në listat përfundimtare janë shpallur fitues në një program studimi të një preference të tyre më të lartë se ai i regjistrimit të ndërmjetëm, do të çregjistrohen nga vetë sekretaritetë mësimore nga programi i studimit ku ishin regjistruar më parë. Këta kandidatë tërheqin dosjen individuale me dokumentet e cilësuar në pikën 7.2 të këtij udhëzimi nga sekretaritetë mësimore, ku janë çregjistruar dhe regjistrohen në programin e studimit në të cilin janë shpallur fitues me listat përfundimtare.

12.2 Sekretaritetë mësimore të fakulteteve në datat 26-30 shtator 2011, prej orës 08:00 deri në orën 18:00, të kryejnë çregjistrimet e kandidatëve të përcaktuar në pikën 7.1 dhe të regjistrojnë kandidatët e rinj fitues, sipas listave përfundimtare të fituesve të shpallura nga AKP-ja dhe të dërguara nëpërmjet MASH-it.

12.3 Veprimet e çregjistrimit paraprak dhe ato të regjistrimit përfundimtar të kandidatëve të rinj të dokumentohen në regjistër të veçantë.

12.4 Në kryerjen e procedurës së regjistrimit përfundimtar në sekretaritetë mësimore të fakulteteve, kandidatët fitues që janë ngjitur në preferencë më të lartë kundrejt regjistrimit të ndërmjetëm, nënshkruajnë në momentin e regjistrimit për dorëzimin e dokumenteve në regjistrin e veçantë, në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 7.3 të këtij udhëzimi.

12.5 Sekretaria mësimore duhet ta pajisë kandidatin që bën regjistrimin, sipas pikës 7.4, me fletëregjistrimi, ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si edhe data e ora e regjistrimit. Fletëregjistrimi duhet të jetë i nënshkruar nga dekani dhe nga kryesekretarja mësimore e fakultetit, si dhe të jetë i vulosur.

12.6 Kandidatët të cilët edhe në listat përfundimtare rezultojnë fitues në të njëjtin program studimi, nuk është e nevojshme të regjistrohen.

12.7 Tarifa e regjistrimit prej 1.550 lekësh, e arkëtuar për regjistrimin fillestar në universitetin X, të kalojë me xhirim nga llogaria e degës së thesarit ku universiteti X ka llogarinë buxhetore, në llogarinë e thesarit të universitetit Y, në të cilin është realizuar regjistrimi përfundimtar i studentit dhe i shoqëruar me listën e studentëve.

13. Në përfundim të procesit të regjistrimit, studentët e regjistruar në regjistrin e veçantë të regjistrohen në regjistrin bazë të studentëve, sipas udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.19, datë 18.7.2007 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", të ndryshuar, dhe të urdhrit nr.150, datë 7.4.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për përcaktimin e kodit të regjistrave të studentëve në IAL".

14. Listat e kandidatëve, sipas programeve të ndryshme të studimit, për kandidatët shqiptarë të trojeve jashtë kufijve të vendit: Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse të vendeve përkatëse, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara me vendimin nr.423, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2011-2012, dërgohen nga Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në MASH, në institucionet publike të arsimit të lartë, deri në datën 5 shtator 2011. Kandidatët shqiptarë të trojeve jashtë kufijve të vendit: Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë dërgojnë direkt në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dosjen e aplikimit në datat 6-15 shtator 2011.

Kandidatët nga Republika e Kosovës aplikojnë direkt në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në programe të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë, në datat 1-15 shtator 2011.

14.1 Administrimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e kandidatëve shqiptarë të trojeve jashtë kufijve të vendit: Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë dhe nga Republika e Kosovës bëhet nga IAL-të publike pritëse mbështetur në notën mesatare të shkollës së mesme edhe notat e lëndëve për të cilat IAL-të publike kanë vendosur koeficientët më të lartë për pranimet në këtë vit akademik.

14.2 Listat e kandidatëve fitues, sipas programeve të ndryshme të studimit, e kandidatëve shqiptarë të trojeve jashtë kufijve të vendit: Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, dhe nga Republika e Kosovës, të përcaktuara nga institucionet publike të arsimit të lartë pritëse, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara me vendimin nr.423, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave, publikohet në vende të dukshme pranë fakulteteve përkatëse të IAL-ve dhe dërgohen në formë të shkruar dhe elektronike nga IAL-të në Drejtorinë e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në MASH, deri në datën 25 shtator 2011.

15. Kandidatët shqiptarë të trojeve jashtë kufijve të vendit: Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, dhe nga Republika e Kosovës, të regjistrohen pranë sekretarive mësimore të fakulteteve në datat 26-30 shtator 2011, duke paraqitur dokumentet përkatëse, sipas pikës 7.2. Dokumentet e parashtruara në pikat 7.2.a dhe 7.2.b të jenë në gjuhën shqipe e të noterizuara në Republikën e Shqipërisë në përfundim të regjistrimeve të këtyre kandidatëve dërgohet lista e tyre në MASH.

16. Me mbylljen e regjistrimit përfundimtar, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në AKP listat përfundimtare origjinale të përgatitura nga AKP-ja, me regjistrimet e kryera për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, të plotësuar, sipas udhëzimit të AKP-së për regjistrimin përfundimtar, në formë të shkruar dhe elektronike në dy kopje, deri në datën 30 shtator 2011.

17. Rektoratet dhe dekanatet në datën 10 shtator 2011, të shpallin në mënyrë të qartë dhe në vende të dukshme, në mjediset e fakulteteve përkatëse, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit dhe të çregjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si dhe njoftime që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e një ecurie normale të procesit të pranimeve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë.

18. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.194, datë 28.4.2011

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE PËR KËTO PROGRAME, PRANË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANËS”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.911, datë 26.8.2009 “Për licencimin e shkollës së lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës””,

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit të Shkencave të Zbatuara të shkollës së lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës”, Tiranë, dhe fillimin e veprimtarisë akademike për programet e reja të studimit, si më poshtë:

a) Programe studimi të ciklit të parë, që realizohen me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në:

- i) Financë-kontabilitet;
- ii) Financë-shkenca juridike.

b) Program studimi i integruar i ciklit të dytë, që realizohen me 300 kredite, me kohëzgjatje normale 5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i Shkencave” në:

- i) Farmaci.

2. Këto programe studimi hapen në bazë të vendimit nr.129, datë 3.12.2010 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Shkolla e lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës” Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjëshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.250, datë 2.6.2011

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT “MENAXHIM-BIZNESI” DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE PËR KËTË PROGRAM, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE, “UNIVERSITETI “KRISTAL””, TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.761, datë 6.12.2005 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””,

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit të Administrimit të Biznesit të shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë, dhe fillimin e veprimtarisë akademike për programin e ri të studimit të ciklit të parë, që realizohet me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në:

i) Menaxhim-biznesi.

2. Ky program studimi hapet në bazë të vendimit nr.125, datë 3.12.2010 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Shkolla e lartë universitare jopublike, “Universiteti “Kristal””, Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.310, datë 4.7.2011

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL” NË “EDUKIM” E “FINANCË-KONTABILITET” DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE PËR KËTO PROGRAME, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE “UNIVERSITETI “KRISTAL””, TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.761, datë 6.12.2005 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””,

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit të Administrimit të Biznesit të shkollës së lartë universitare jopublike, “Universiteti “Kristal””, Tiranë, dhe fillimin e veprimtarisë akademike për programin e ri të studimit të ciklit të dytë, që realizohet me 90 kredite, me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master Profesional” në “Financë-kontabilitet”.

2. Ky program studimi hapet në bazë të vendimit nr.154, datë 18.2.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Hapjen pranë Fakultetit të Shkencave Politike të shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë, dhe fillimin e veprimtarisë akademike për programin e ri të studimit të ciklit të dytë, që realizohet me 90 kredite, me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master Profesional” në “Edukim”.

4. Ky program studimi hapet në bazë të vendimit nr.171, datë 15.4.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

5. Shkolla e lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.336, datë 14.7.2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PRAKTIKAVE
PROFESIONALE PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR TË MËSUESIT”**

Në përputhje me nenin 11 të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Duke filluar nga viti shkollor 2011-2012 të zhvillohen procedurat e organizimit dhe zhvillimit të praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit në përputhje me rregulloren e “Organizimit dhe zhvillimit të praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”.

2. Ngarkohen për hartimin e programeve të praktikës profesionale Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal në MASH.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Koordinimit Rajonal në MASH, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në MASH, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, si dhe drejtoritë arsimore rajonale e zyrat arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.371, datë 28.7.2011

**PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË GJEOSHKENCAVE DHE ENERGJISË, UJIT DHE MJEDISIT
(IGJEUM), PRANË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr.490, datë 6.7.2011 të Këshillit të Ministrave “Për shfuqizimin e vendimeve nr.560 dhe nr.561, datë 22.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare” dhe “Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare””,

URDHËROJ:

1. Krijimin e Institutit e Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, si njësi kryesore, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës nga bashkimi dhe riorganizimi i Institutit të Gjeoshkencave dhe Institutit të Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

2. Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) ka për mision:

a) kërkimin shkencor, bazë dhe të aplikuar;
b) formimin universitar të thelluar të studentëve dhe shkencëtarëve të rinj;
c) transferimin e njohurive dhe teknologjive, si dhe monitorimet në shkallë kombëtare në fushat e sizmologjisë, hidrometeorologjisë, pasurive natyrore, të gjeoriskut, gjeoinxhinierisë, gjeoinformacionit, klimës dhe mjedisit.

3. Detyrat kryesore të Institutit janë:

a) Monitorimi, regjistrimi dhe analizimi i vazhdueshëm i aktivitetit sizmik të vendit, nëpërmjet rrjeteve kombëtare të monitorimit sizmologjik dhe gjeodinamik, si dhe njoftimi në kohë reale i organizmave shtetërorë përgjegjës për emergjencat civile dhe i publikut për rreziqet nga tërmetet;

b) Studime të thelluara në fushën e sizmologjisë dhe të sizmotektonikës për tërmetet që godasin vendin tonë;

c) Studimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i dukurive dhe veprimtarisë hidrologjike, si dhe njoftimi, në kohë reale, i organizmave shtetërorë përgjegjës për emergjencat civile dhe i publikut për rreziqet nga përmbytjet;

d) Studimi i fenomeneve gjeologjike (gjeofizike, gjeokimike, gjeomekanike etj.) dhe ndërtimi i hartave gjeologjike tematike;

e) Studimi dhe vlerësimi i pasurive minerale, të materialeve të ndërtimit, burimeve nëntokësore, të energjisë, resurseve ujore nëntokësore;

f) Studimi i rreziqeve natyrore (gjeoriskut) dhe të atyre të shkaktuara nga veprimtaria e njeriut (rrëshqitjet, erozionet, përmbytjet, tërmetet, ndotjet, venddepozitat, subsidencat minerare etj.);

g) Zhvillimi i modeleve gjeoinformatike;

h) Studimi dhe monitorimi i dukurive atmosferike të motit dhe ndryshimeve klimatike, si dhe njoftimi, në kohë reale, i organizmave shtetërorë përgjegjës për emergjencat civile dhe i publikut për rreziqet nga ngjarjet e jashtëzakonshme atmosferike;

i) Studimi i gjendjes së mjedisit natyror, nivelit të erozionit dhe të ndotjes së ajrit e të ujërave në tërësi si ato sipërfaqësore dhe nëntokësore;

j) Implementimi dhe përdorimi i teknologjive të informacionit dhe të telekomunikacionit për mbledhjen, transmetimin dhe përpunimin e informacionit të sistemeve digjitale në fushat e sizmologjisë e të hidrometeorologjisë;

k) Formimi universitar, kryesisht në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, dhe kualifikimi i thelluar i shkencëtarëve të rinj.

4. Struktura e institutit, përbërja, funksionimi, si edhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.

IGJEUM, për shkak të misionit dhe shërbimeve që ofron, fton në mbledhjet e këshillit të institutit një përfaqësues nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, një nga Ministria e Mjedisit, një nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe një përfaqësues nga Ministria e Brendshme. Këta anëtarë të ftuar marrin pjesë në mbledhjet e këshillit të institutit, pa të drejtë vote.

5. Procesi i bashkimit dhe riorganizimit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Institutit të Energjisë, Ujit dhe Mjedisit në Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit të përfundojë brenda datës 15.9.2011.

6. Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit të lirojë objektin “Ndërtesa Qendrore e Institutit të Hidrometeorologjisë”, Tiranë dhe të transferohet në godinën ekzistuese të Institutit të Gjeoshkencave, brenda datës 31.8.2011.

7. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

VENDIM
Nr.61, datë 13.7.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BEKIM ENERGJETIK” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”, 9 dhe 13, pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 12, 13, 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.7.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Bekim Energjetik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Bekim Energjetik” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Bekim Energjetik” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Kryezi 1” me fuqi 0.6 MW dhe “Kryezi i Epërm” me fuqi 0.2 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.182, datë 30.6.2011

**PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO DIMENSION”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “FTONI A” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Ftoni A” sh.p.k., për t’u licencuar si operator radiofonik privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T’i japë shoqërisë “Ftoni A” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin Shkodër.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.183, datë 30.6.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO HIT FM”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “RADIO HIT FM” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Radio Hit FM” sh.p.k., për t’u licencuar si operator radiofonik privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë shoqërisë “Radio Hit FM” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin Elbasan.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.184, datë 30.6.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO UNIVERS”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “RADIO UNIVERS” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Radio Univers” sh.p.k., për t’u licencuar si operator radiofonik privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë shoqërisë “Radio Univers” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qarqet Tiranë-Durrës-Fier-Vlorë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.185, datë 30.6.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO NUMBER ONE”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “RADIO NUMBER ONE” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor” dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Radio Number One” sh.p.k., për t’u licencuar si operator radiofonik privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë shoqërisë “Radio Number One” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal qarqet Tiranë-Durrës-Fier-Vlorë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.186, datë 30.6.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO SPRINT”
SUBJEKTIT: PERSON FIZIK JULIAN SEJKO

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor” dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit person fizik Julian Sejko, për t’u licencuar si operator radiofonik vendor privat dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë personit fizik Julian Sejko, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin Gjirokastrë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen: struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.202, datë 30.6.2011

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK ME PËRSËRITËS “RADIO DEUTSCHE WELLE”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Sami Neza	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës “Radio Deutsche Welle”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21 dhe neni 33 pika 2 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VËREN SE:

Me vendimin nr.68, datë 16.11.2001, KKRT-ja ka licencuar subjektin juridik “Deutsche Welle” për ritransmetimin e programeve të huaja radio në “Radio Deutsche Welle”, për një periudhë prej 4 vjetësh, me zonë licencimi pjesërisht prefekturat Tiranë, Durrës, Lezhë, Fier, me nr.001/PPH licence. Me vendimet nr.424, datë 21.3.2006 dhe nr.147, datë 22.10.2010, KKRT-ja ka rinovuar licencën për subjektin radiofonik me përsëritës “Radio Deutsche Welle”.

Me shkresën e datës 23.5.2011, subjekti radiofonik me përsëritës “Radio Deutsche Welle”, ka depozituar pranë KKRT-së kërkesën si më poshtë vijon:

“... “Radio Deutsche Welle” nuk do të vazhdojë më përdorimin e frekuencës 106.0 MHz, e për rrjedhojë, licenca e lëshuar në datën 16.11.2001, nuk do të jetë më e vlefshme...””.

KKRT-ja konstaton se në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 33, pika 2 “Licenca bëhet e pavlefshme kur... i licencuari heq dorë prej saj me shkrim”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit në bazë të nenit 7 pika 21 dhe nenit 33, pika 2, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën me nr.001/PPH për subjektin radiofonik me përsëritës “Radio Deutsche Welle”.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.203, datë 30.6.2011

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË TË DHËNAT E
PARAQITURA NË KËRKESËN PËR MARRJE LICENCE TË SHOQËRISË “SCORPION” SHPK,
LICENCUAR PËR SUBJEKTIN RADIOFONIK PRIVAT VENDOR “RADIO MARIA”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti “Scorpion” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 25 dhe neni 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së,

VËREN SE:

KKRT-ja me vendimin nr.104, datë 24.9.2010 “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Maria””, ka vendosur mosrinovimin paraprak të licencës së shoqërisë “Scorpion” sh.p.k., për operatorin radiofonik privat vendor “Radio Maria”, për shkaqet e parashtruara në vendim. Subjekti kishte të drejtë që brenda 30 ditëve të parashtronte pretendimet dhe plotësimet përkatëse lidhur me këto vendime të KKRT-së.

Me shkresën e datës 2.12.2010, shoqëria “Scorpion” sh.p.k. ka depozituar në KKRT dokumentacionin plotësues për rinovimin e licencës për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Maria”. Gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit plotësues rezultoi se dokumentacioni për rinovimin e licencës kishte përsëri mangësi. Në këto kushte, KKRT-ja me vendimin nr.107, datë 28.3.2011 “Mbi caktimin e një afati të ri për paraqitjen e plotësimeve të dokumentacionit për rinovim licence të subjektit radiofonik privat vendor “Radio Maria”, vendosi të shtyjë afatin për paraqitjen e plotësimeve të dokumentacionit për rinovim licence, duke i dhënë të drejtën subjektit “Scorpion” sh.p.k., për të paraqitur plotësimet dhe mangësitë përkatëse brenda 30 ditëve.

Me shkresën e datës 26.5.2011, shoqëria “Scorpion” sh.p.k. ka depozituar pranë KKRT-së plotësimet, mangësitë dhe sqarimet përkatëse. Konkretisht subjekti ka depozituar:

- Deklaratat noteriale nr.rep.2061, nr.kol.1154, datë 26.5.2011 dhe nr.rep.2062, nr.kol.1155, datë 26.5.2011, të firmosura përkatësisht nga ortakët Prenka Lazraj dhe shoqata “Radio Maria”;
- Programacionin e grupuar sipas karakterit të emisionit;
- Kërkesën e depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për ndryshimin e objektit të veprimtarisë së shoqatës “Radio Maria”.

Në vazhdim me shkresën e datës 8.6.2011, subjekti radiofonik privat vendor “Radio Maria” ka depozituar pranë KKRT-së vendimin nr.2066/6, datë 8.6.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit rezultoi se objekti i veprimtarisë i shoqatës “Radio Maria”, “Ka për qëllim ushtrimin e aktivitetit radiofuzionit sonor e publikimin e periodikëve me karakter kulturor, etnik, nëpërmjet publikimit të prodhimeve editoriale, transmetimeve të programeve të ndryshme, të vetëprodhuara ose të blera nga të tretët”.

Ndërsa, për sa u përket ndryshimeve të ndodhura në shoqërinë “Scorpion” sh.p.k., me shkresën e protokolluar pranë KKRT-së me nr.1854 prot., datë 13.12.2010, shoqëria “Scorpion” sh.p.k., ka paraqitur pranë KKRT-së, njoftimin në lidhje me ndryshimet në strukturën e ortakëve të shoqërisë. Subjekti njofton se:

“... te shoqëria “Scorpion” sh.p.k., janë bërë ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Është larguar ortaku Julian Priska dhe është shtuar ortaku Prenka Lazraj”.

Njoftimi është bërë në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “I licencuari detyrohet të njoftojë Këshilli Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës...”.

Sa më sipër, KKRT-ja e gjen të drejtë kërkesën e paraqitur nga subjekti.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 25 dhe nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe mbështetur në kërkesën e subjektit,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Maria” në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
 2. Miratimin e ndryshimeve në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje licence.
 3. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
 4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Pika 1 e këtij vendimi i shtrin efektet nga data 3.1.2010.
 6. Pika 2 e këtij vendimi hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Nr.204, datë 30.6.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË TË DHËNAT E PARAQITURA NË KËRKESËN PËR MARRJE LICENCE TË SHOQËRISË “SCORPION” SHPK, LICENCUAR PËR SUBJEKTIN RADIOFONIK ME PËRSËRITËS “WORLD FAMILY”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti “Scorpion” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 25 dhe neni 30 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së,

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr.103, datë 24.9.2010 “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës World Family”, ka vendosur mosrinovimin paraprak të licencave të shoqërisë “Scorpion” sh.p.k. për operatorin radiofonik privat me përsëritës “Radio World Family”, për shkaqet e parashtruara në vendim. Subjekti kishte të drejtë që brenda 30 ditëve të parashtronte pretendimet dhe plotësimet përkatëse lidhur me këto vendime të KKRT-së.

Me shkresën e datës 2.12.2010, shoqëria “Scorpion” sh.p.k. ka depozituar në KKRT dokumentacionin plotësues për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës “Radio World Family”. Gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit plotësues rezultoi se dokumentacioni për rinovimin e licencës kishte përsëri mangësi. Në këto kushte, KKRT-ja me vendimin nr.108, datë 28.3.2011 “Mbi caktimin e një afati të ri për paraqitjen e plotësimeve të dokumentacionit për rinovim licence të subjektit radiofonik me përsëritës “Radio World Family”, vendosi të shtyjë afatin për paraqitjen e plotësimeve të dokumentacionit për rinovim licence, duke i dhënë të drejtën subjektit “Scorpion” sh.p.k. për të paraqitur plotësimet dhe mangësitë përkatëse brenda 30 ditëve.

Me shkresën e datës 26.5.2011, shoqëria “Scorpion” sh.p.k. ka depozituar pranë KKRT-së plotësimet, mangësitë dhe sqarimet përkatëse. Konkretisht subjekti ka depozituar:

- Deklaratat noteriale nr.rep.2061, nr.kol.1154, datë 26.5.2011 dhe nr.rep.2062, nr.kol.1155, datë 26.5.2011, të firmosura përkatësisht nga ortakët Prenka Lazraj dhe shoqata “Radio Maria”;

- Programacionin e grupuar sipas karakterit të emisionit;
- Kërkesën e depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për ndryshimin e objektit të veprimtarisë së shoqatës “Radio Maria”.

Në vazhdim, me shkresën e datës 8.6.2011, subjekti ka depozituar pranë KKRT-së vendimin nr.2066/6, datë 8.6.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit rezultoi se objekti i veprimtarisë i shoqatës “Radio Maria”, “Ka për qëllim ushtrimin e aktivitetit radiofuzionit sonor e publikimin e periodikëve me karakter kulturor, etnik, nëpërmjet publikimit të prodhimeve editoriale, transmetimeve të programeve të ndryshme, të vetëprodhuara ose të blera nga të tretët”.

Ndërsa, për sa u përket ndryshimeve të ndodhura në shoqërinë “Scorpion” sh.p.k., me shkresën e protokolluar pranë KKRT-së me nr.1854 prot., datë 13.12.2010, shoqëria “Scorpion” sh.p.k. ka paraqitur pranë KKRT-së njoftimin në lidhje me ndryshimet në strukturën e ortakëve të shoqërisë. Subjekti njofton se:

“... te shoqëria “Scorpion” sh.p.k. janë bërë ndryshimet si më poshtë vijon:

2. Është larguar ortaku Julian Priska dhe është shtuar ortaku Prenka Lazraj.”

Njoftimi është bërë në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës...”.

Sa më sipër, KKRT-ja e gjen të drejtë kërkesën e paraqitur nga subjekti.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 25 dhe nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe mbështetur në kërkesën e subjektit,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës “Radio World Family” për ritransmetimin e programeve të huaja.
 2. Miratimin e ndryshimeve në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje licence.
 3. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
 4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Pika 1 e këtij vendimi i shtrin efektet nga data 15.10.2009.
 6. Pika 2 e këtij vendimi hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Nr.206, datë 30.6.2011

MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË LICENCËN E SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TV POJAN”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e njoftimit të paraqitur nga z.Haki Trakalaçi, për ndryshimet e ndodhura në licencën e televizionit privat kabllor “Tv Pojan”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 22 dhe neni 30 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr.831, datë 24.4.2009, ka licencuar subjektin person fizik z. Haki Trakalaçi,

për televizionin privat kabllor “Tv Pojan”, duke u autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për një periudhë prej 6 vjetësh, për të penetruar me sinjal në komunën Dërmenas.

Në datën 20.6.2011, z. Haki Trakalaçi ka depozituar pranë KKRT-së njoftimin për ndryshimet e ndodhura në subjektin televiziv privat kabllor “Tv Pojan”, duke kërkuar miratimin e tyre nga KKRT-ja.

Konkretisht subjekti shprehet se:

“...në datën 6.6.2011 jemi paraqitur para noterit në qytetin e Fierit dhe kemi deklaruar se jemi dakord që këtë aktivitet me të gjitha pajisjet e tij, duke përfshirë sistemimin kabllor, si dhe pajisjet në studio përkatëse, unë Haki Trakalaçi t'i kaloj në pronësi të dhëndrit tim, z.Emin Grenica dhe të bashkëpunojë me përvojën time për përmbushjen e të gjitha detyrimeve në aktivitetin e transmetimit kabllor sipas licencës së KKRT-së.

Për sa më sipër, kreu regjistrimin në QKR dhe rrjedhimisht edhe ndryshimin e NIPT-it. Ekstraktin e regjistrimit tregtar të subjektit Emin Grenica, me fushë të veprimtarisë “Televizion kabllor lokal” dhe një certifikatë regjistrimi të personit fizik të tatueshëm me nr.identifikimi L12721403G, po e paraqesim bashkëngjitur.

Në mbështetje të nenit 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar: licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjektit që ka fituar këto të drejta miratimi i jepet në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje. Kur këshilli nuk e miraton kalimin për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, i ofron frekuencat që i përkasin kësaj licence për një konkurrim të ri kandidaturash”.

Në rastin konkret, z.Haki Trakalaçi, i licencuar si person fizik nga KKRT-ja, i ka shitur z.Emin Grenica, aktivitetin e televizionit kabllor privat “Tv Pojan”, dhe për kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca kërkohet miratimi nga ana e KKRT-së.

Në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës... dhe arsyet përkatëse, paraprakisht dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve...”.

Subjekti, në bazë të nenit të sipërcituar, ka dërguar pranë KKRT-së shkresën me ndryshimet e ndodhura në operatorin televiziv privat kabllor “Tv Pojan”, duke respektuar afatin ligjor, si dhe duke shprehur arsyet e bërjes së këtyre ndryshimeve. Konkretisht subjekti është shprehur se “...duke marrë parasysh punët e mëdha, moshën time, por edhe problemet familjare të kohëve të fundit, u detyrova të kërkoja bashkëpunimin me partner të tjerë, e të përballonim administrimin korrekt të këtij subjekti kabllor. Kjo më detyron që së bashku me z.Emin Grenica, i afërm i familjes sime, i njohur prej meje, të bashkëpunonim për ruajtjen e investimeve të tjera”.

Sa më sipër, KKRT-ja e gjen të drejtë e të mbështetur kërkesën e subjektit.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 22 dhe nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i heqë personit fizik z.Haki Trakalaçi, licencën për televizionin privat kabllor “Tv Pojan”.
2. Licenca nr.069/RTV kabllor bëhet e pavlefshme.
3. T'i japë personit fizik z.Emin Grenica, licencë me afat vlefshmërie sipas përcaktimit në licencën nr.069/RTV kabllor, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për të penetruar me sinjal në komunën Dërmenas.
4. Licenca e re ka të njëjtën përmbajtje me licencën nr.069/RTV kabllor lidhur me kushtet e licencës, ku përfshihen: struktura programore, zona e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
5. Ngarkohet administrata e KKRT-së për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 13.8.2011
Doli nga shtypi më 15.8.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 28 lekë